



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 27.05.2025
Numër protokolli: 3546/2025

A.nr.660/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar në procedurë sipas ankesës A.nr.660/2025, të datës 15.04.2025, të parashtruar nga ankuesja SH.B-V, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.660/2025 e datës 15.04.2025, të parashtruar nga ankuesja SH.B-V.

A r s y e t i m

SH.B.V, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 15.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2491/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.660/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit/Ministria së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit në kërkesën e saj të datës 18.02.2025 për vazhdimin e misionit diplomatik në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Slloveni.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 16.04.2025 ka dërguar kërkesën

për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Këshilli më datë 24.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga kjo e fundit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën e ankueses të datës 15.04.2025 të parashtruar në Këshill; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; E-mailin e datës 15.04.2025 dërguara nga ankuesja në Këshill; Kërkesën e datës 15.02.2025; Çertifikatë e datës 17.02.2025; E-mailin e datës 20.03.2025 dërguara nga ankuesja për Sekretarin e Përgjithshëm të MPJD-së; E-mailin e datës 09.03.2025 dërguar nga ankuesja për Sekretarin e përgjithshëm të MPJD-së; Kërkesën e ankueses të datës 18.02.2025 dërguar përmes e-mailit tek Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së; E-mailin e datës 03.02.2025 dërguar nga A.M për ankuesen me njoftimin për Vendimin Nr.Ref/38/KM/Nr.443; Shkresë e datës 18.11.2024; Shkresë e datës 20.02.2025; Shkresë e datës 05.03.2025; Vendimin Nr.443 të datës 03.02.2025 të Ministres së MPJD-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.04.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 24.04.2025; Vendimin e datës 10.12.2020 të Ministres së MPJD-së; Akt Emërimit të ankueses të datës 07.04.2025; E-mailin e datës 26.05.2025 dërguar nga Këshilli për Njësinë e Burimeve Njerëzore të MPJD-së; Përgjigjen e datës 26.05.2025 e MPJD-së për Këshillin; Vendimin e datës 25.02.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të **përfundoj procedimi administrativ** i filluar me ankesën e ankueses, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesja sipas Akt të Emërimit të datës 05.03.2014, ka pasur të themeluar marrëdhënien e punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në pozitën “Zyrtare e Lartë e Protokollit”, ndërsa e njëjta përmes Vendimit të datës 10.12.2020 të Ministres së Ministrisë së Punëve të jashtme dhe Diasporës, është caktuar të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Lubjanë/Republika e Sllovenisë, me mandat katër (4) vjeçar, ndërsa data e fillimit të misionit të saj diplomatik ka qenë e përcaktuar të jetë 01.02.2021, ashtu që data e përfundimit të detyrës së saj ka qenë e paracaktuar me datë 31.01.2025.

Me datë 31.01.2025, Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka nxjerrë Vendimin Nr.443 përmes të cilit ka vendosur që ankuesja pas përfundimit të mandatit të saj në misionin diplomatik-Ambasadën e Republikës së Kosovës në Lubjanë/Slloveni, të kthehet në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kthimi i saj është përcaktuar të ndodh me datë 31.03.2025. Po ashtu Kolegji i Këshillit thekson faktin se Vendimi Nr.443 i datës 31.01.2025 i nxjerrë nga Ministrja e MPJD-së, përmban këshillën juridike me të cilën pala ankuese udhëzohet në ushtrimin e mjeteve juridike (të drejtën e ankesës) pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në afat prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të vendimit në fjalë, ndërsa ankuesja me datë 03.02.2025 përmes e-mailit zyrtar, është njoftuar me aktin e nxjerrë nga organi i punësimit.

Ankuesja nuk e ka ushtruar të drejtën e parashtrimit të ankesës ndaj aktit, respektivisht Vendimit të datës 31.01.2025 të Ministres së MPJD-së, mirëpo e njëjta me datë 18.02.2025 ka parashtruar kërkesën te Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së, me qëllimin që të njëjtës t'i mundësohet vazhdimi i misionit diplomatik deri me datë 24.06.2025, me arsyetimin se e njëjta e ka vajzën në shkollë dhe do ta kishte të nevojshme ta përfundojë semestrin apo vitin shkollor, ndërsa po ashtu me datë 09.03.2025 kërkon sqarime lidhur me trajtimin e kërkesës së saj dhe e zgjeron kërkesën e saj fillestare me arsyetimin se vajza e saj është duke pranuar trajtim shëndetësor (seanca të fizioterapisë) pasi që e ka lënduar gjurin, dhe po ashtu me datë 20.03.2025 kërkon sqarime për mos trajtimin e kërkesës së saj me arsyetimin se kërkesa e saj duhet të pranohet si fakt i aprovimit në heshtje sipas dispozitave ligjore të LPPA-së.

Ankuesja për shkak heshtjes administrative të organit të punësimit në kërkesën e saj të datës 18.02.2025, për vazhdimin e mandatit-shërbimit në misionin diplomatike deri me datë 24.06.2025, me datë 15.04.2025 ka parashtruar ankesën në Këshill me pretendimin ankimor se organi i punësimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 86 të LPPA-së, lidhur me trajtimin e kërkesës së saj, po ashtu i janë cenuar të drejtat që burojnë nga konventa mbi të drejtat e fëmijëve, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e ankueses, ndërsa të detyroi organin e punësimit, MPJD-në, që ankueses t'ia vazhdojë mandatin në shërbimin diplomatik deri me datë 24.06.2025

Kolegji i Këshillit pas pranimit të përgjigjes në ankesë nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPJD-së me datë 23.04.2025, konstatoi se ankuesja me datë 01.04.2025 ka pranuar Aktin e Emërimit nga organi i punësimit, dhe se e njëjta është sistemuar në pozitën “Zyrtare e Lartë e Protokollit”, pozitë të cilën e kishte mbajtur para se të shkonte për shërbim në misionin diplomatik sipas aktit të emërimit të datës 05.03.2014, andaj Kolegji i Këshillit pas konstatimit se ankuesja me datë 01.04.2025 e ka pranuar dhe nënshkruar aktin e emërimit pa vërejtje, me datë 26.05.2025 përmes e-mailit zyrtar i drejtohet Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke kërkuar sqarime shtesë, **citoj**: “Këshilli me date 24.04.2025 ka pranuar shkresat e lendes për ankesën e ankueses Shpresa Bajrami-Veliu, mirëpo e kemi te nevojshme te ofroni sqarime si ne vijim: **1.** Ju lutem a mund te na e konfirmoni faktin nëse ankuesja është kthyer nga misioni, **2.** Nëse te njëjtës i është lëshuar vendim për sistemim dhe po ashtu nëse e njëjta është duke u paraqitur në vendin e punës ne MPJD.”, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MPJD, me datë 26.05.2025 kthen përgjigje dhe e konfirmon se e ankuesja është kthyer nga misioni dhe ka filluar punën sipas Vendimit të datës 25.02.2025 për sistemimin e saj në pozitën të cilën e ka mbajtur para se të shkoj në misionin diplomatik, njëherit të njëjtës iu ka lëshuar edhe Akt i Emërimit me datë 01.04.2025.

Kolegji i Këshillit, duke marrë parasysh rrethanat juridike dhe gjendjen faktike, sikurse ajo që ankuesja ka pranuar vendimin e datës 25.02.2025 për sistemimin e saj në pozitën të cilën e ka mbajtur para se të emërohej për shërbimin në misionin diplomatik, dhe po ashtu ta ketë nënshkruar Aktin e Emërimit pa vërejtje me datë 01.04.2025 duke u kthyer në vendin e saj të punës, veprime dhe rrethana të cilat nuk i kishte bërë të ditura në ankesën e saj të parashtruar me datë 15.04.2025, Kolegji i Këshillit mori përbazë dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur

organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.”, dhe erdhi në përfundimin se është plotësuar parakushti ligjor që të përfundoi procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankueses të datës 15.04.2025, pasi që objekti për të cilën ishte nisur kjo procedurë është bërë i pamundur apo i kotë, ngase ankuesja përmes ankesës së datës 15.04.2025 të parashtruar në Këshill kishte kërkuar që të njëjtës t’i njihet e drejta për vazhdimin e shërbimit në misionin diplomatik deri me datë 24.05.2025, ndërsa e njëjta me datë 01.04.2025 e ka pranuar pa vërejtje Aktin e Emërimit dhe ka filluar të vijoj paraqitjen në punë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në pozitën “Zyrtare e Larte e Protokollit”, sikurse e njëjta nuk i kishte kundërshtuar me ankesë asnjërën nga aktet me të cilat është njoftuar se misioni i saj do të përfundojë dhe se e njëjta do të kthehet në vendin e saj të punës në MPJD, prandaj mi këtë bazë dhe konstatimin e dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit pasi që konstatoi se objekti i ankesës së ankueses është i kotë, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi që të përfundoi procedimin administrativ në këtë çështje administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.660/2025, datë 27/05/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, Sh.B-V;
- Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore dhe Komisionit të Ankesave), si dhe; Arkivit të KPMShCK-së.